

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 9 MAJ 2022

E dashur Flutura,

E dini që kam respektin maksimal për punën tuaj, për letërsinë tuaj, dhe vijmë të dyja nga bota e letrave. Duke qenë se vijmë nga bota e letrave, unë nuk do të bëj as replikë dhe as fjalim, por do të ndaj me ju një artikull të një reviste holandeze. Revista është në gjuhën holandeze dhe unë, Flutur e dashur, do t'ju dërgoj në holandisht. Unë nuk e kuptoj atë gjuhë, por e kam përkthimin e saktë në shqip të artikullit në vijim. (Ndërhyrje nga salla pa mikrofon) Po mirë, se nuk e kanë lexuar kolegët. Unë nuk e diskutoj që ju i lexoni të gjitha, ashtu sikurse unë, sepse thashë që vijmë të dyja nga e njëjta botë. Krijuesit e "Wie is de Mol" arritën të prezantojnë te miliona teleshikues një vend ende të panjohur dhe të bukur: Shqipërinë. Në gjurmët e emisionit "Wie is de Mol" revista "Champion", që është një ndër revistat më të njohura në fushën e operatorëve turistike në Holandë, udhëtoi në këtë vend të vogël të Ballkanit, që me të vërtetë i ka të gjitha. Cila është sfida?! Shqipëria është një vend relativisht i vogël dhe lehtësisht i aksesueshëm, por ndonjëherë, në varësi të asaj që jemi mësuar, është, gjithashtu, një sfidë. Gjuha është e pakuptueshme, transporti publik funksionon ndryshe nga Holanda, rrugët mund të jenë ndoshta edhe me pak pluhur dhe Veriu i vendit ndonjëherë, vende-vende, është më pak i aksesueshëm ngaqë fryn erë. Por le ta themi tani, - thotë revista holandeze "Champion", - Shqipëria i ka të gjitha dhe bën gjithçka. Shqipëria është si Greqia me ushqime po aq të freskëta dhe me një të kaluar po aq emocionuese, me mbetje të ruajtura mirë nga koha e lashtë greke, romake, bizantine, osmane dhe komuniste.

Shqipëria i ngjan Kroacisë me të njëjtën klimë mesdhetare dhe me plazhe po aq të bukura, por me shumë më pak turistë. Shqipëria i ngjan edhe Austrisë dhe Norvegjisë me male po aq mahnitëse dhe kullota të gjelbëruara, por shumë më të ngrohta dhe me çmime më të lira. Infrastruktura në Shqipëri nuk është aq e zhvilluar sa në vendet e përmendura më sipër, por, sigurisht, në tre-katër vjetët e fundit është bërë një përparim i jashtëzakonshëm. Kjo infrastrukturë mund t'ju çojë në kaq shumë vende të bukura, në një vend relativisht të vogël, siç na i ka treguar tashmë edhe në televizion programi "Wie is de Mol"; thotë revista holandeze, e dashur Flutura. Gjithçka është me bollëk, vazhdon ajo revistë, të cilën as nuk e kemi paguar, as nuk e kemi botuar dhe as nuk e kemi shpërndarë ne, por me siguri ju e keni lexuar para meje. Në Jug të Shqipërisë, pak larg nga ishulli i njohur grek i Korfuzit, do të gjeni plazhe në zona të zhvilluara turistike, si Ksamili dhe Saranda. Këtu fillon e ashtuquajtura riviera shqiptare, duke u ngjitur deri në rrugën më të famshme bregdetare të vendit, në Qafën e Llogorasë në malet Akrokeraune, një nga tri vargmalet e vendit. Pikat panoramike janë të shumta në një vend, ku kalonte Jul Çezari dhe ku bashkohen deti Adriatik me detin Jon. Ushqimi këtu, gjithashtu, është fantastik me shumë peshq, ullinj, fiq dhe shegë dhe këto me një çmim mesatar prej 10 deri në 15 euro për pjatë në një restorant. Proveni byrekun, si një variant shqiptar, një pjatë mesdhetare shpesh e mbushur me perime vendase. Ajo që e bën kuzhinën shqiptare kaq të veçantë është rikthimi tek ushqimet e ndaluara.

Në kohën e komunizmit, të diktatorit Hoxha, nuk kishte vend për gatime të veçanta apo verëra të shijshme. Ushqimi racionohej ose futej në kanaçe. A ju pëlqen t'i hani në bregdet karkalecat e detit Adriatik? Duhet të dini se në kohën e komunizmit karkalecat e detit u jepeshin si ushqim derrave.

Vetëm në fund të Luftës së Ftohtë karkalecat e shijshëm depërtuan në tregun shqiptar dhe u investua për rritjen e tyre. Ky është vetëm një shembull i rikthimit tek ai që dikur quhej “ushqim i ndaluar”, trashëgimia botërore e Shqipërisë. Në pranverë dhe në vjeshtë, - thuhet sërish në revistë, - mund të hani ende në Shqipëri. Kjo gjë e bën rivierën një vend edhe më tërheqës. Gjatë eksplorimit të bregdetit do të hasni shumë site arkeologjike, si Butrini, një qytet bregdetar i mbushur me histori, qoftë shqiptare, greke, romake, bizantine, mesjetare, napolitane, otomane apo veneciane. Është një vend arkeologjik me një akropol të ruajtur jashtëzakonisht mirë, pika më e lartë e një qyteti, me pamje nga ishulli grek i Korfuzit.

Butrinti ishte dikur një vend i harruar, edhe pse i mbipopulluar për dekada të tëra në Lashtësi e në Mesjetë, por në vitin 1992 iu bashkua listës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s dhe nuk është e vetmja trashëgimi botërore që ka Jugu. I veçantë është edhe Amfiteatri i portit të Durrësit. Veçanërisht me sfondin e një qyteti jo shumë të bukur mbase, por për t'u mahnitur vërtet, vizitoni Gjirokastrën, Beratit, të cilat janë fjalë për fjalë qytetet e Epokës së Gurit. Madje Berati, është 4000-vjeçar dhe shtrihet përballë një faqeje mali të thepisur. Mund të hani në kalanë, e cila është ndërtuar mbi një kodër. Vizitoni kalanë e Gjirokastrës, gjithashtu. Nga maja e kalasë e kupton vërtet se me çfarë mënyre të paimagjinueshme janë ndërtuar dhe janë ruajtur këto qytete. Po ashtu, pas Gjirokastrës mund të notosh në pishinat magjike të ujit të kaltër të njohur si “Syri i Kaltër”. Alpet shqiptare A dëshironi pak aksion? Bregdeti jugor është një zonë e njohur për paragliding. Po ashtu, rafting rekomandohen shumë në grykën e Osumit. Kanionet e Osumit janë kanionet më të mëdha të Shqipërisë, prandaj edhe janë quajtur si “grand canyon” shqiptare. Shkëmbinjtë vertikalë gëlqerorë e bëjnë rafting-un një aventurë shumë të bukur, pasi ndihesh sikur je gjithnjë në lëvizje. Në pranverë akulli shkrihet dhe e bën rafting edhe më emocionues. Osumi ndodhet në breg të detit, në zemër të Shqipërisë. Pas bregdetit, kuzhinës dhe qyteteve të gurta të trashëgimisë botërore, mund të niseni drejt Veriut për të vizituar Alpet e Shqipërisë. Pasi të jeni në Veri të vendit, mund të bëni një nga udhëtimet më të bukura me varkë në Europë: udhëtimin me varkë në liqenin e Komanit, i cili nisët nga fshati me të njëjtin emër. Në Koman kalon një ditë dhe një ditë me diell është si të jesh në Austri. Pika e fundit e këtij udhëtimi është Fierza, një pikënisje e re nga ku mund të ecni në Veriun e freskët dhe të gjelbër të Shqipërisë. Këtu mund të udhëtoni nga një fshat malor në një fshat tjetër malor, nëpër male, livadhe e pyje dhe ndonjëherë në fusha dëbore, madje edhe në verë. Një alpinist i zjarrtë mund të bëjë, gjithashtu, një ecje sfiduese me pamje nga vende të ndryshme të Ballkanit, si Kosova, Mali i Zi e Maqedonia e Veriut, pra të gjitha në të njëjtën kohë i keni nga Shqipëria.

Unë mund ta vazhdoja leximin e artikullit, por këtë gjë e kanë shkruar gazetarët dhe ata, të cilët kanë shoqëruar të gjitha xhirimet e këtij reality show, siç e dini shumë të ndjekur dhe mund t'ju konfirmoj përmes operatorëve turistikë se kërkesat nga tregu holandez i turizmit janë çdo javë në rritje. Sikur ne të vazhdojmë të shkruajmë të gjithë nga pak kaq bukur për Shqipërinë tonë i bëjmë një shërbim shumë të madh Shqipërisë, krenarisë sonë për Shqipërinë, se kemi nevojë pikërisht që ta ngremë atë që të tjerët thonë. Siç e thamë pak më parë, ta shikojmë edhe ne ndonjëherë vendin tonë, siç e shikojnë ata që thjesht na duan, sepse Shqipëria është e bukur dhe ofron gjithçka. Faleminderit!